



VENDIM

Nr. 82 Datë 13.09.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SH.A PËR
PERIUDHEN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhen e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhen e tretë rregullatore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI